

STATUT DHE AKT THEMELIMI
PER KRIJIMIN SI PERSON JURIDIK TE SHOQERISE
“WATER SHOP”

(Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar)

Ne baze te ligjit 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", dhe, ligjit nr.9723. date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" i nenshkruari:

•**Albano Meçorrapaj**, i datelindjes 20.02.1990 lindur ne Mesaplik dhe banuese ne Tirane, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, pajisur me karte identifikimi me nr. id J00220132U.

FORMIMI I SHOQERISE

Neni 1

Formohet shoqeria e quajtur **“WATER SHOP shpk”**

Qe ketu e me poshte referuar si "Shoqeria", e cila themelohet nga **ortaket e sipercituar**, si me poshte vijon:

QENDRA E SHOQERISE

Neni 2

Selia zyrtare e Shoqerise ndodhet ne adresen: Rruga 1 Maji, Hyrja -1, Zona Kadastrale 8531 Nr Pasurie 13/53-N1, Fier.

Shoqeria ka te drejte te hape dege apo filiale, zyra perfaqesimi, ne te gjithe vendin gjate aktivitetit te saj, brenda ose jashte territorit te vendit.



KOHEZGJATJA E VEPRIMTARISE EKONOMIKE

Neni 3

Kohezgjatja e veprimtarise se Shoqerise eshte per nje periudhe kohore **te papercaktuar**.

OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

Neni 4

“Import-Export te aparaturave te trajtimit te ujit. Tregti me shumice dhe pakice i aparaturave te trajtimit te ujit te pishem, instalimi i zbutesave dhe aksesore qe lidhen me to.”

Neni 5

Kjo shoqeri mund te ndryshoje emertimin e saj, vendqendrimin, objektin e aktivitetit, te shtoje ortakete, te rrise kapitalin sipas vendimeve te Ortakeve te Vetem dhe sipas parashikimeve te ligjit 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

KAPITALI I SHOQERISE

Neni 6

Kapitali fillestar i shoqerise eshte 100.000 leke, i ndare ne 1 kuote.


Z.Albano Meçorrapaj, zoteron kuota kapitali 100% dhe zoteron 1(nje) kuote.

Kapitali zoterohet 100% nga ortaku i vetem i shoqerise.

Ortaket e vetem mund te vendosin te rrisin kapitalin e shoqerise ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi dhe me vendim te ortakëve te vetem. Detyrimet e ortakëve kundrejt shoqerise do te mbulohen vetem me pjesen e kapitalit te paguar prej tyre. Ortaket nuk do te kene asnje pergjegjesi tjeter per detyrime te tjera te shoqerise.

Neni 7

Kapitali i shoqerise mund te shtohet ose te zvogelohet sipas dispozitave ligjore dhe sipas vendimit te Asamblese se Ortakeve te Vetem te Shoqerise.



REGJISTRIMI I SHOQERISE

Neni 8

Shoqeria tregtare deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave qe permban ky Statut si dhe te legjislacionit shqiptar ne fuqi. Ajo konsiderohet e krijuar ne daten e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit te bizneseve (QKB) sipas nenit 43 te ligjit 9723 date 3.5.2007.

Neni 9

KALIMI I KUOTAVE

Pjeset shoqerore te ortakut te vetem perputhen me pjesen e tij ne kapitalin e shoqerise. Kuotat e kapitalit te shoqerise si dhe te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo te kalohen nepermjet:

- ne kapitalin e shoqerise
- shitblerjes se kuotave
- trashegimise
- dhurimit
- çdo menyre tjeter te parashikuar ne ligj.


Pjeset e tij çdo ortak i shoqerise mund t'ua ofroje te treteve, te cilet nuk jane anetare ne shoqeri. Ne rast se shoqeria do te kete ne te ardhmen me shume se nje ortak, ne kete rast ortaku i cili ka vendosur te transferoje ose te shese kuotat e tij, duhet t'i drejtoje nje kerkese me shkrim Organit Administrativ duke saktësuar çmimin e shitjes, i cili duhet te jete i arsyeshem dhe te jete i njejte me ate qe do t'i ofrohet dhe nje personi te trete jashte shoqerise si dhe te dhenat e bleresit. E drejta e perparemise per nenshkrimin e kapitalit eshte ne proporcion me kuotat e secilit prej ortakeve.

Personi qe kalon kuoten dhe ai qe fiton ate pergjigjen ne menyre solidare ndaj shoqerise per detyrimet qe rrjedhin nga zoterimi i kuotes nga çasti i kalimit te kuotave deri ne çastin e regjistrimit te kalimit.

Shoqeria regjistron kalimin e kuotave sipas nenit 43 te ligjit 9723 .

Neni 10

Emertimi i shoqerise tregtare, kapitali themeltar, emri i administratorit , duhet te jete te permendura ne te gjitha aktet e nxjerra nga kjo shoqeri dhe qe ju drejtohen te tretave. Shoqeria do te kete vulen e saj me madhesi te zakonshme dhe me permbajtjen perreth saj.



Neni 11

Shoqeria vepron nen regjimin e prones private dhe merr persiper *vetem* te drejtat dhe detyrimet kontraktore

Organet e shoqerise jane:

- Asambleja e Ortakeve te Vetem te Shoqerise
- Administratori i shoqerise.

KOMPETENCAT E ORTAKUT TE VETEM

Neni 12

Per menyren e drejtimit dhe ushtrimit te aktivitetit te shoqerise, Ortaket e *vetem* shprehen me vendime per gjithçka qe eshte ne kompetencat e tyre.

Neni 13

Marrja e vendimeve te Ortakeve te Vetem regjistrohen ne regjistrin e vendimeve te ortakeve te vetem ,mbajtja e procesverbaleve dhe te gjitha dokumentet e tjera qe kane te bejne me te duhet te behen sipas legjislacionit ne fuqi per kete qellim.

Neni 14

THIRRJA E ASAMBLESE


Asambleja e pergjithshme thirret sa here qe eshte e nevojshme per te mbrojtur interesat e shoqerise.

Neni 15

PJESEMARRJA NE VENDIME

Çdo ortak, ne rastet kur shoqeria do te kete me shume se nje ortak, ka te drejte te marre pjese ne vendime si dhe disponon nje numer votash barabarte me pjeset e kapitalit themeltar qe ai zoteron.

Ne rastin e marrjes se vendimeve qe kerkojne nje shumice te zakonshme asambleja e pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30% te kuotave.



Ne rastin kur asambleja duhet te vendose per çeshtje qe kerkojne shumice te kualifikuar si per shembull ndryshime ne statut, zmadhimi ose zvogelimi i kapitalit te regjistruar, shperndarja e fitimeve, riorganizimi dhe shperndarja e shoqerise ajo mund te marre vendime te vlefshme kur vendos me tre te katertat e votave te ortakeve pjesemarres personalisht, ose qe votojne me shkrese po me mjete elektronike.

ADMINISTRIMI


Neni 16

Shoqeria administrohet nga nje administrator i cili caktohet ne statutin e shoqerise dhe me pas nga Vendimet e Ortakeve te vetem apo nga Asambleja e Ortakeve ne rast se shoqeria do te kete me shume ortak. Administratori qendron ne detyre per nje periudhe **kohore 5 (pese) vjeçare**, me te drejte riemerimi nepermjet vendimit te Ortakeve te Vetem te Shoqerise. Ne rast se gjate kesaj periudhe shfaqen probleme paaftesie nga ana e secilit ortak, Ortaket vendosin shkarkimin e tij. Ne asnje rast ortaket nuk i duhet te justifikojne apo provojne se cilat jane shkaqet per te cilat shkarkon administratorin. Ne çdo rast jane ortaket te cilet vleresojne nese ka shkaqe te arsyeshme per shkarkimin e administratorit.

Administratori detyrohet te kryeje te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise duke zbatuar politikat tregtare te vendosura nga asambleja e pergjithshme. Ai kujdeset per mbajtjen sakte dhe te rregullt te dokumenteve, dhe te librave kontabel te shoqerise.

Ai pergatit dhe nenshkruan bilancin vjetor te shoqerise, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise, dhe se bashku me propozimet per shperndarjen e filimeve ja paraqet keto dokumente asamblese se pergjithshem te ortakeve per miratim.

Ai ka te gjitha kompetencat per te vepruar me te tretet ne emer te shoqerise dhe ne interes te saj ne te gjitha rrethanat me perjashtim te kompetencave qe ligji dhe Statuti i shoqerise ja jep shprehimisht Ortakeve te Vetem.



Administratori emerohet me nje afat kohor 5 (pese) vjeç ar.

Administratorit nuk i lejohet te kontraktoje me te tretet ne çfaredo lloj forme qofte, nuk i lejohet te marri hua tek shoqeria, te japi pelqimin per çeshtje te ndryshme ne emer te saj, nuk i lejohet te jape paradhenie, te behet dorezanes apo te garantoje ne emer te shoqerise apo te ortakeve te vetem etj., perveç rasteve kur ai ka marre nje **miratim perkates me shkrim nga ortaket.**

Administratori ka te drejte te kryeje vetem ato veprime te cilat kane te bejne me administrimin e perditshem dhe te zakonshem te shoqerise.

Administratori mund te japi prokura tek te tretet brenda kufijve qe ligji e lejon dhe ne kufijte qe i lejojne Ortaket e vetem apo Asambleja e Ortakeve per kategori te caktuara veprimesh.

Te gjitha veprimet e tjera duke perfshire pagesa, detyrime per tu paguar, veprime me institucionet bankare ku perfshihen transferta bankare terheqje parash etj., do te kryhen nga administratori vetem pasi te jete dhene miratimi me shkrim nga ortaket e vetem.

Administratori i shoqerise eshte caktuar Briken Pajaj, i datelindjes 05.08.2001, lindur ne Fier dhe banuee ne Tirane, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, pajisur me karte identifikimi me nr. K10805019B.

MARREDHENIET E PUNES

Neni 17

Marredheniet e punes rregullohen nepermjet kontrates se punes dhe legjislacionit te punes ne fuqi. Shoqeria merr persiper te respektoje rregullat ne fuqi te punesimit dhe te punesuarit jane te detyruar qe te respektojne Statutin e kesaj shoqerie dhe rregullat e brendshme te saj. Te punesuarit duhet te pergjigjen per demet qe i shkaktojne kesaj shoqerie nga veprimet ose mosveprimet e tyre sipas ligjit.

KONFIDENCIALITETI, RUAJTJA E SEKRETIT

Neni 18

Konsiderohen si konfidenciale dhe nuk lejohet te behet publike permbajtja e tyre per te tretet e te gjitha akteve dhe dokumenteve qe jane percaktuar si te tilla nga administratori i shoqerise.

EKSPERTET OSE REVIZORET KONTABEL



Neni 19

Kontrolli mbi veprimtarine e shoqerise si dhe gjithë aktivitetin e shoqerise i besohet nje eksperti ose revizori kontabel. Ky ekspert do te emerohet dhe qendroje ne detyre sipas parashikimeve te ligjit perkates. Ortaku cakton dhe shperblimin perkates kur nuk ka norma te veçanta ligjore.

VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, SHPERNDARJA E FITIMEVE

Neni 20

Viti financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 dhjetor te secilit vit. Administratori merr masat me qellim hartimin e bilanceve, rezultateve ekonomike te fitimeve apo humbjeve dhe inventarizimin. Pas analizimit te çeshtjeve te mesiperme si dhe shlyerjen e detyrimeve, te ardhurat e tjera do ti kalojne ortakut te shoqerise.

Neni 21

SHPERNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHOQERISE

Ne rast se shoqeria shperndahehet per do lloj arsye Ortaku i vetem percakton menyren e likuidimit, emerone nje ose me teper likuidator dhe pergatit te gjitha dokumentet e nevojshme per c 'regjistrimin e saj nga Qendra Kombetare e Regjistrimit te biznesit QKB.

DISPOZITA TE PERGJJTHSHME

Neni 22

Persa eshte shprehur ne kete statut i referohemi ligjit 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", dhe ligjit nr.9723. date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit". Çdo ndryshim behet ne perputhje me kete Statut dhe nuk prek personalitetin juridik te kesaj shoqerie.

Data. 03.06.2024

ORTAKU I VETEMI SHOQERISE

Albano MEÇORRAPAJ

Albano Meçorrapaj

